



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 236/3 Prot

Tiranë, më 27/02/2020

VENDIM

Nr. 06, datë 27.02.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Për Arsim Cilësor”, përfaqësuar nga znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 236 Prot., datë 10.02.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Universiteti Politeknik i Tiranës” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 10.01.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. Kopje të dokumentacionit të plotë të tenderit Nr. REF-75334-06-19-2018, me objekt “Blerje Materiale Pastrimi” Universiteti Politeknik i Tiranës dhe çdo dokument tjetër mbështetës.
2. Kopje të planit të prokurimeve publike për vitin 2018 të institucionit tuaj.
3. Kopje të njoftimit të ftesës për ofertë për këtë kontratë prokurimi.
4. Kopje të dokumenteve standarte të tenderit.
5. Kopje të procesverbaleve të mbajtura gjatë procedurave të përcaktimit të fituesit të tenderit.
6. Kopje të shpalljes së fituesit të tenderit.
7. Kopje të raportit teknik.
8. Kopje të preventivit.
9. Kopje të kontratës publike të lidhur midis autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik kontraktues.

Autoriteti publik me shkresën nr. 46/1 Prot., datë 22.01.2020 ka kthyer pjesërisht përgjigje duke cituar ndër të tjerat se: *“Dokumentacioni që mund të vihet në dispozicion në mbështetje të ligjit për të drejtën e informimit, është ai për të cilin autoriteti publik ka detyrimin e publikimit. Dokumentacion ky i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në buletin periodik të vitit 2018”* si dhe ka refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit tjetër me argumentin se: *“Referuar pikave 1 dhe 3 të nenit 21 dhe nenit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar një pjesë e dokumentacionit objekt kërkesë për informacion përmbajnë të dhëna me karakter konfidencial të cilat mund të çënojnë sekretin tregtar të palëve pjesëmarrëse në proces. Dokumentet si kontrata e lidhur nëpërmjet palëve, raportet teknike, procesverbalet gjatë zhvillimit të procedurës, etj, përmbajnë informacione konfidenciale dhe si të tilla, nuk mund t’i vihen në dispozicion personave të interesuar, përfshirë edhe palët pjesëmarrëse në proces.*

Pas përgjigjes së dhënë nga autoriteti publik, ankuesi pretendon se nuk i është vënë në dispozicion informacioni i plotë dhe ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, ankesën nr. 236 Prot., datë 10.02.2020, me objekt *“refuzimin e dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*, duke kërkuar nga Komisioneri ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi së ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në këtë kuadër, pas vlerësimit të ligjshmërisë së ankimit, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me qëllim verifikimin e pretendimeve të ankuesit, Komisioneri me Urdhrit nr. 32, datë 14.02.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë autoritetit publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion.

Pas depozitimit të urdhrimit dhe regjistrimit pranë autoritetit publik me nr. 283 Prot., datë 17.02.2020, grupi i inspektimit kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit, me qëllim evidentimin e personit/ave përgjegjës për ndjekjen e shkresës me qëllim përmbushjen e detyrimit për informim.

Koordinatorja vendosi në dispozicion të grupit të inspektimit kopje të kërkesës të Qendrës “Për Arsim Cilësor” të administruar në protokollin e autoritetit me nr. 46 prot., datë 13.01.2020. Nga këqyrja e saj vërehet se në kartelën shoqëruese nuk rezulton që nga titullari i autoritetit publik t’i ketë kaluar për trajtim ndonjë nëpunësi.

Gjithashtu u këqyr kopja e shkresës kthim përgjigje nr. 46/1 Prot., datë 22.01.2020, në të cilën rezulton se është trajtuar nga specialisti i Sektorit të Prokurimeve.

Grupi i inspektimit kontaktoi edhe me nëpunësin që ka trajtuar kërkesën për të konfirmuar nëse informacioni i kërkuar disponohet nga autoriteti publik, si dhe për të administruar qëndrimin përfundimtar të nëpunësit të angazhuar me çështjen objekt inspektimi.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës ka të bëjë me një prokurim publik, i cili i nënshtrohet dispozitave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Neni i këtij ligji përcakton kufizime mbi autoritetin publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare si dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Siç mund të vërehet nga dispozita e mësipërme, konfidencialiteti lidhet me aspekte teknike, sekrete tregtare dhe të dhëna të tjera konfidenciale me të cilat autoriteti publik është njohur ose i janë vënë në dispozicion nga operatorët ekonomikë gjatë procesit të prokurimit publik. Pra, në këtë përcaktim nuk përfshihen procesverbalet gjatë zhvillimit të procedurës, raportet teknike apo kontrata për punë publike e cila edhe nga vetë emri është vetëshpjeguese për natyrën e saj. Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e informacionit nuk rezultoi i bazuar në ligj.

Për më tepër, edhe nëse do të kishte aspekte konfidenciale, në frymën e nenit 17 pika 6 e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, sipas të cilit “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”, autoriteti publik duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të dokumenteve, të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tyre.

Në lidhje me pikën 2 “*Kopje të planit të prokurimeve publike për vitin 2018 të institucionit tuaj*”, konstatohet se autoriteti publik ka referuar faqet zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, Ministrisë së Financave dhe të Universitetit Politeknik të Tiranës, por nuk ka vendosur në dispozicion të ankuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni, në kundërshtim kjo me pikën 2 të nenit 16 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin parashikohet se: “*Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuarit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...*”.

Në lidhje me pikat 3 dhe 6 të kërkesës, rezultoi se autoriteti publik ka përmbushur detyrimin për dhënie informacioni.

Sa më sipër, nga hetimi administrativ rezultoi se informacioni i kërkuar nga Qendra “Për Arsim Cilësor”, disponohet nga autoriteti publik duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe kufizimet e pasqyruara në legjislacionin e zbatueshëm nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar. Për rrjedhojë, në kushtet kur autoriteti publik, disponon informacionin, është përgjegjës për vënien e tij në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Nëpunësi i angazhuar me çështjen sqaroi se: *“Dokumentacioni i vënë në dispozicion subjektit ankimues përmbush qëllimin e shprehur në kërkesë lidhur me studimet statistikore dhe krahasimore me vendet e rajonit të Ballkanit. Informacioni i siguruar nëpërmjet dokumentacionit të vënë në dispozicion si: a) Formulari i njoftimit të Kontratës, b) Formulari i njoftimit të fituesit dhe c) Formulari i kontratës së lidhur, përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm për qëllimet e shprehura.*

Lidhur me pjesën tjetër të dokumentacionit, kërkuessit i është bërë e qartë që një pjesë e saj ka karakter konfidencial në kuptim të pikës 3, të nenit 21 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku përcaktohet: “Pa cënuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet kontraktore mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një-gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cënon interesin publik apo interesat ligjorë dhe ekonomikë të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë”.

Megjithatë, nga ana e autoritetit publik, subjekti ankimues është sqaruar se informacioni për dokumentat e tjera objekt kërkesë mund të konsultohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, si institucioni kryesor i cili disponon të gjithë procedurat e prokurimit të cilat janë publike në faqen web të saj.

Procedurat e prokurimit publik, planet e prokurimit për vitin 2018, apo çdo dokumentacion tjetër janë publikuar nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës në faqet zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, Ministrisë së Financave dhe faqes zyrtare të Insitucionit.

Pra, është mëse e qartë që në rastin objekt shqyrtimi, subjekti ankimues nuk legjitimohet lidhur me pretendimin e tij për shkelje të së drejtës së informimit, pasi qartazi legjislacioni në fuqi ka parashikuar mënyrën e marrjes së informacionit nga subjektet e interesuara.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga autoriteti publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Në lidhje me pikën e 1 të kërkesës *“Kopje të dokumentacionit të plotë të tenderit Nr.REF-75334-06-19-2018, me objekt “Blerje Materiale Pastrimi” Universiteti Politeknik i Tiranës dhe çdo dokument tjetër mbështetës”,* konstatohet se në këtë pikë përfshihen edhe dokumentet të cilat kërkohen në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 të kërkesës për informacion si pjesë e dosjes së prokurimit.

Përsa i përket pretendimit të autoritetit publik se: *“Referuar pikave 1 dhe 3 të nenit 21 dhe nenit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dokumentet si kontrata e lidhur nëpërmjet palëve, raportet teknike, procesverbalet gjatë zhvillimit të procedurës, etj, mund të çenojnë sekretin tregtar të palëve pjesëmarrëse në proces...”,* ky argument nuk qëndron.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me pikat 1, 2, 4, 5, 7, 8 dhe 9 të ankesës së Qendrës “Për Arsim Cilësor” ndaj Autoritetit Publik/Universiteti Politeknik i Tiranës, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 236 Prot., datë 10.02.2020 të Qendrës “Për Arsim Cilësor”, përfaqësuar nga znj. _____, ndaj Autoritetit Publik “Universiteti Politeknik i Tiranës”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 1, 2, 4, 5, 7, 8 dhe 9 (Kopje të dokumentacionit të plotë të tenderit Nr. REF-75334-06-19-2018, me objekt “Blerje Materiale Pastrimi” Universiteti Politeknik i Tiranës dhe çdo dokument tjetër mbështetës; Kopje të planit të prokurimeve publike për vitin 2018 të institucionit tuaj; Kopje të dokumenteve standarte të tenderit; Kopje të procesverbaleve të mbajtura gjatë procedurave të përcaktimit të fituesit të tenderit; Kopje të raportit teknik; Kopje të preventivit dhe Kopje të kontratës publike të lidhur midis autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik kontraktues) të kërkesës së datës 10.01.2020, brenda datës 05.3.2020.
3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikat 3 dhe 6 (Kopje të njoftimit të ftesës për ofertë për këtë kontratë prokurimi dhe Kopje të shpalljes së fituesit të tenderit) të kërkesës për informacion datë 10.01.2020.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 27.02.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

